
	<p><b>Republika e Kosovës</b>          Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p><b>Komuna e Prishtinës</b>          Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	
---	--	---

01-219

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05-391/02-25809/24 dt.16.02.2024, të kërkuësve/bashkëpronarëve, Rrustem Gashi, Baki Thaqi, Xhafer Sinani, Agim Morina, Nysret Selimi, Neriman, Anita, Inesa, Redon e Endrit Tahiri, Enver Beselica, Blerim Papaj, Vahide Gashi, Alban, Fadil e Murat Dushullovc, Hamit Gashi, Enis Halimi, Bedri Ahmeti nga Prishtina dhe investitorit “Vllezërit Asllani” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Malush Kosova”, pn, dhe me përfaqësues Qazim Asllanaj nga Glllogoci, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesat: “A6/01”, “A6/02”, “A6/03”, “A6/04”, “A6/05”, “A6/06”, “A6/07”, “A6/08” si dhe Ndërtesa garazhuese “Zona A” dhe “Zona B”, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “A6”, te Planit Rregullues “Mati 1”, ne Prishtinë, në rr. “Ndue Përlleshi”, “Dukagjin Vula” dhe “Bistica Ilire” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë administrative, me datë 27.09.2024, lëshon këtë:

**CERTIFIKATË E PËRDORIMIT**

**I. I LEJOHET** kërkuësve / bashkëpronarëve , Rrustem Gashi, Baki Thaqi, Xhafer Sinani, Agim Morina, Nysret Selimi, Neriman, Anita, Inesa, Redon e Endrit Tahiri, Enver Beselica, Blerim Papaj, Vahide Gashi, Alban, Fadil e Murat Dushullovc, Hamit Gashi, Enis Halimi, Bedri Ahmeti nga Prishtina dhe investitorit “Vllezërit Asllani” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Malush Kosova”, pn, dhe me përfaqësues Qazim Asllanaj nga Glllogoci, sipas kërkesës 05-391/02-25809/24 dt.16.02.2024, përdorimi i kompleksit me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesat: “A6/01” me etazhitet B+P+5, “A6/02” me etazhitet B+P+5, “A6/03” me etazhitet B+P+5, “A6/04” me etazhitet B+P+5, “A6/05” me etazhitet B+P+5, “A6/07” me etazhitet B+S+P+4 “A6/08” me etazhitet B+P+5 si dhe ndërtesat garazhuese “Zona A” me etazhitet B+0, “Zona B” me etazhitet 2B+0, te ndërtuar sipas “Vendimit për Lejimin e Ndërtimit”, 05 Nr.351/02-28991/20 dt.18.09.2020, në parcelën kadastrale nr. 1666-0, ZK Matiçan, konkretisht në kuadër të bllokut urban “A6”, te Planit Rregullues “Mati 1”, ne Prishtinë në Prishtinë.

**II.** Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Ndue Përlleshi” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: Nr. 83, 83/1, dhe 83/2, në rruga “Dukagjin Vula” Nr. 5, 7, 9, 11, 13, 25, 27, 29, 31, 33, 35, dhe 37 në Prishtinë, si dhe në rrugën “Bistica Ilirie” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: Nr. 2, 4, 6, 8, 10, 12, 14, 16, 18, 20, 24, 26, 30, 32, 34, 38, 40, 42, 44, 46, 48, 50, 52, 54, 56, 60, 62, 64, 66, dhe 68, dhe e njejtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njërive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### Arsyetim

Kërkuesit / bashkëpronarët, Rustem Gashi, Baki Thaqi, Xhafer Sinani, Agim Morina, Nysret Selimi, Neriman, Anita, Inesa, Redon e Endrit Tahiri, Enver Beselica, Blerim Papaj, Vahide Gashi, Alban, Fadil e Murat Dushullovc, Hamit Gashi, Enis Halimi, Bedri Ahmeti nga Prishtina, me investitor "Vllezerit Asllani" sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qazim Asllani nga Gillogoci, me kërkesën 05-391/02-25809/24 dt.16.02.2024, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksin me ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesat: "A6/01" me etazhitet B+P+5, "A6/02" me etazhitet B+P+5, "A6/03" me etazhitet B+P+5, "A6/04" me etazhitet B+P+5, "A6/05" me etazhitet B+P+5, "A6/07" me etazhitet B+S+P+4, "A6/08" me etazhitet B+P+5 si dhe ndërtesat garazhuese "Zona A" me etazhitet B+0, "Zona B" me etazhitet 2B+0, të ndërtuar në kuadër të bllokut urban "B-3/b\_12 te terësisë "B", të Planit Rregullues "Muhaxhirët, ne Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1666-0, ZK Matiçan, ndërtuar sipas "Vendimit për Lëshimin e Ndërtimit", 05 Nr.351/02-28991/20 dt.18.09.2020, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-229597/23 dt. 12.01.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Egzon Elshani/Marigona Asllanaj; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Agon Fazliu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Alban Zubaku; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Arbnor Haradini; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Agim Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve për mbrojtje nga zjarri, nga mbikqyrësi Granit Aziri; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Ibrahim Jonuzi me nr. të licensës 105;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm si dhe ndërtesa garazhuese mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat





nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që kompleksi me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, dhe ndërtesa garazhuese mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**I dorëzohet:** Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-25809/24 DT. 27.09.2024**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu  
*B. Vllasaliu*



